

# Statistikat e transportit

## Gusht, 2018

**Tiranë, më 27 Shtator 2018:** Volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte, në muajin Gusht 2018 është 315 mijë ton, duke u rritur 5,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017.

Në tetëmujorin 2018, volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte është 2.579 mijë ton, duke u ulur me 1,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017.

Volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë është 1.986 mijë ton-kilometër, duke u ulur me 3,8 % krahasuar me Gusht 2017.

Për tetëmujorin 2018, ky volum është 12.192 mijë ton-kilometër, duke u ulur me 24,8 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017.

**Tab. 1 Transporti i mallrave me det, hekurudhë dhe ajër**

Periudha	Det ton	Hekurudhë 000/tkm	Ajër* ton
Gusht - 2017	299.941	2.065	189
Gusht - 2018	314.893	1.986	165
Ndryshimi vjetor (%)	5,0	-3,8	-12,7
Janar - Gusht 2017	2.619.430	16.221	1.478
Janar - Gusht 2018	2.578.599	12.192	1.421
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	-1,6	-24,8	-3,9

*Përfshin mallrat dhe postën*

Në muajin Gusht 2018, volumi i mallrave të transportuar me ajër është 165 ton.

Në tetëmujorin 2018, me ajër janë transportuar 1.421 ton mallra. duke u ulur 3,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë 2017.

Numri i fluturimeve të kryera, në Gusht 2018, është 2.880 duke shënuar një rritje me 8,3 %, ndaj Gusht 2017.

**Për publikim 27/09/2017**

Në tetëmujorin 2018, janë kryer 17.412 fluturime, duke u rritur me 9,0 %, krahasuar me njëjtën periudhë të një viti më parë.

**Tab. 2 Treguesit e transportit ajror**

Periudha	Numri i shoqërive ajrore	Numri i fluturimeve	Numri mbikalimeve
Gusht - 2017	20	2.660	22.543
Gusht - 2018	20	2.880	23.222
Ndryshimi vjetor (%)	-	8,3	3,0
Janar - Gusht 2017	20	15.978	113.712
Janar - Gusht 2018	20	17.412	120.818
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	-	9,0	6,2

Numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë detare në Gusht 2018 është 447.063 pasagjerë, krahasuar me Gusht 2017, ky tregues është rritur 6,1 %.

Në tetëmujorin 2018, kanë udhëtuar me linjë detare 1.126.351 pasagjerë, duke u rritur me 0,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në tetëmujorin 2018, transporti ajror i pasagjerëve zë 62,7 % të transportit gjithsej. Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore, në tetëmujorin 2018 është 1.992.530 duke u rritur me 14,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

**Tab.3 Transporti i pasagjerëve sipas mënyrës së udhëtimit**

Periudha	Transporti i pasagjerëve		
	Hekurudhë	Det	Ajër
Gusht - 2017	14.985	421.256	328.317
Gusht - 2018	16.534	447.063	376.290
Ndryshimi vjetor (%)	10,3	6,1	14,6
Janar - Gusht 2017	55.035	1.120.320	1.741.707
Janar - Gusht 2018	60.033	1.126.351	1.992.530
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	9,1	0,5	14,4

### **Eksportet/importet e mallrave sipas mënyrës së transportit**

Në Gusht 2018, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 68 mld lekë dhe 48,7 % e tyre u transportua me det.

Në tetëmujorin 2018, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 621 mld lekë dhe 53,9 % e tyre u transportua me det.

**Eksportet e mallrave**


Në Gusht 2018, mallrat e eksportuara me det zënë 51,0 %, me rrugë 41,3 % dhe me ajër 0,4 %.

Mallrat e eksportuara me rrugë, në Gusht 2018, janë rritur me 7,1 % dhe me det janë rritur me 0,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës.

Në tetëmuji 2018, mallrat e eksportuara me det zënë 58,2 %, me rrugë 35,7 % dhe me ajër 0,4 %.

Mallrat e eksportuara me rrugë, në tetëmuji 2018, janë rritur me 16,2 % dhe me hekurudhë janë ulur me 22,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës.

**Fig. 1 Struktura e eksporteve sipas mënyrës së transportit, Gusht 2018**



**Importet e mallrave**


Në Gusht 2018, mallrat e importuara me det zënë 47,8%, me rrugë 46,7 % dhe me ajër 3,2 %.

Mallrat e importuara me hekurudhë, në Gusht 2018, janë ulur me 24,3 % dhe me rrugë janë rritur me 0,3 %, krahasuar me Gusht 2017.

Në tetëmuji 2018, mallrat e importuara me det zënë 51,8 %, me rrugë 43,3 % dhe me ajër 2,8 %.

Mallrat e importuara me rrugë, në tetëmuji 2018, janë rritur me 1,9 % dhe me hekurudhë janë ulur me 21,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës.

Fig.2 Struktura e importeve sipas mënyrës së transportit, Gusht 2018



# Metodologji

## **Përkufizime:**

**Transport:** Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit tokësor, ajror dhe detar.

**Transporti hekurudhor:** Çdo lëvizje e mallrave dhe/pasagjerëve duke përdorur mjete me rrota të drejtuar mbi binarë.

**Transport detar:** Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur anije tregtare në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me det.

**Transport ajror:** Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur avionë në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me ajër.

**Eksportet** janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

**Vlera F.O.B:** Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

**Importet** janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

**Vlera C.I.F:** Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

**Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007)** është një nomenklaturë mallrash e përdorur kryesisht për statistikën e transportit

**Burimi i të dhënave:** Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

*Të dhënat e transportit detar, ajror dhe hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/reth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.*

## **Shpjegimi i simboleve**

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë